



Naša uprava

institut alternativa



SHOQËRIA CIVILE PËR ADMINISTRATË TË MIRË: TË SHËRBEJË DHE TA MERITOJË!



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Kjo broshurë u krijua në kuadër të projektit „Shoqëria Civile për Qeverisje të Mirë: Shërbim dhe Meritë!“, i cili implementohet nga Instituti Alternativa, Bonum, Natura, Horizonti i Ri dhe Qendra për Gazetari Hulumtuese dhe financohet nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit mbështetës për zhvillimin e organizatave lokale të shoqërisë civile dhe Fondacionit Ballkanik për Demokraci (BTD), projekt i Fondit Marshall të SHBA (GMF). Përbajtja e kësaj broshure është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet qëndrimet e donatorëve.

FJALË E SHKURTËR HYRËSE

Kjo broshurë përmbledh diskutimet nga tri konferencat për qeverisje të mirë, të cilat i ka organizuar Instituti alternativa me partnerë në kuadër të projektit “Shoqëria civile për administratë të mirë: Të shërbejë dhe ta meritojë!”.

Në raport me kornizën aktuale strategjike për reformën e administratës publike në Malin e Zi dhe me sfidat kyçe për zbatimin e reformës aktuale, ajo po ashtu përmban edhe një pasqyrë të problemeve dhe çështjeve, monitorimi i të cilave është cilësuar si shumë i rëndësishëm nga sektori civil.

Botimi është i dedikuar në radhë të parë organizatave të shoqërisë civile, me qëllim të informimit më të mirë të tyre për qëllimet kyçe të reformës së administratës publike, dilemat lidhur me zbatimin e saj dhe kontributin potencial të tyre për arritjen e rezultateve në këtë fushë.

Qëllimi i reformës së administratës publike është që ajo të jetë me afër dhe më shumë në shërbim të qytetarëve. Kjo është arsyeja pse roli i organizatave të shoqërisë civile në monitorimin e arritjes të rezultateve të reformës është i pazëvendësueshëm. Ajo duhet të jetë autonome dhe e orientuar kah rezultatet, pra, e pavarur nga Qeveria dhe në një masë më të vogël e drejtuar kah proceset dhe aktivitetet zyrtare, të cilat shpesh i largojnë qytetarët nga efektet kryesore që do të duheshin t’i arrijnë.

Shpresojmë se temat të cilat i kemi ngritur gjatë ngjarjeve dhe punëtorive në kuadër të projektit do t’ju shërbejnë si inspirim për t’u kyçur më shumë në këtë reformë gjithëpërfshirëse.

Ekipi i Institutit alternativa

Podgoricë, prill 2018

VËSHTRIM RETROSPEKTIV: PRITSHMËRITË NGA STRATEGJIA PËR REFORMËN E ADMINISTRATËS PUBLIKE 2016-2020

Në prag të miratimit të Strategjisë për Reformën e Administratës Publike, në maj të vitit 2016, organizuam konferencën “Shoqëria civile për administratë të mirë – Drejt institucioneve më të përgjegjshme”. Gjatë diskutimit, sektori civil e njohu problemin e pjesëmarrjes së pamjaftueshme në vendimmarrje dhe mungesën e profesionalizmit në administratë si pengesa kyçe për reformën. Problemi i “organeve në përbërje të ministrive”, gjegj. i përgjegjësisë së pamjaftueshme të tyre, është theksuar veçanërisht gjatë diskutimit dhe atëherë u cek nevoja për themelimin e një Ministrie të re të Administratës Publike, e cila u themelua disa muaj më vonë – në dhjetor të vitit 2016.

Stevo Muk, kryetar i Këshillit Drejtues të Institutit alternativa (IA), ceku se administrata karakterizohet nga konkurrenca e dobët për pozitat udhëheqëse profesionale më të rëndësishme, ka shumë nëpunës në vende ku punohet pak, ndërsa pak sosh ku ka shumë punë.

Refik Bojaxhiq, sekretar gjeneral i Bashkësisë së Komunave, theksoi se Bashkësia e Komunave është në dispozicion për të gjithë si partner për forcimin e transparencës së administratës dhe fuqizimin e bashkëpunimit me organizatat joqeveritare.

Ai theksoi se, në lidhje me vetëqeverisjet lokale, çështjet prioritare të cilat do të duheshin të zgjidheshin deri në vitin 2020 janë: **problemi i sistemit të papërcaktuar të shërbimit civil, reforma e veprimtarisë komunale dhe financimi i vetëqeverisjeve lokale.**

“Vetëqeverisja lokale ka nevojë për mbështetje institucionale, gjegj. është e

domosdoshme të formohet një Ministri për Vetëqeverisje Lokale ose për Administratë Publike”, - tha Bojaxhiq.

Në këtë ngjarje është theksuar se ndryshimet në administratën tonë janë bërë të përhershme, pasi që procesi i reformës po zgjatë nga viti 2002.

Danijela Nedelković-Vukçević, në atë kohë kryeshefe e Drejtorisë për Administratë Shtetërore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përmendi punën për përgatitjen e Projekt – strategjisë për Reformën e Administratës Publike për Periudhën 2016 – 2020.

“Kjo është strategjia më e mirë që është përgatitur ndonjëherë”, tha ajo, duke theksuar se disa nga problemet kyçe, ku duhet të punohet më shumë, janë forcimi i kapaciteteve administrative dhe planifikimi i kuadrove, si dhe problemi i koordinimit të pamjaftueshëm në mes të organeve.

Branislav Radulović, anëtar i Senatit të



Institucionit Shtetëror të Revizionit, nga këndvështrimi i institucionit, rëndësia e të cilit për kontrollin e financave publike është e pazëvendësueshme, vuri në dukje problemin e ndryshimeve të shpeshta të strukturave organizative në administratën tonë.

Këto ndryshime pasqyrohen negativisht në ushtrimin e kontrollit mbi organet e administratës.

“Nuk ekziston asnjë resor, i cili është në vazhdimësi i njëjtë”, tha ai, duke përkujtuar se edhe reforma e administratës publike si e tillë dikur ishte nën juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, për të kaluar pastaj në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ai gjithashtu vuri në dukje problemin e organeve në përbërje të ministrive dhe rikujtoi nenin 28 të Ligjit për Adminis-

tratë Shtetërore, i cili e definon këtë institucion.

“Ky nen përcakton që organet në përbërje formohen kur vëllimi dhe natyra e punëve të tyre nuk kërkojnë organizim të posaçëm dhe pavarësi në punë”, shpjegoi Radulloviq, duke shtuar se është paradoks që në Malin e Zi për organe të tilla konsiderohen Administrata Tatimore ose Administrata e Policisë, e cila me pesë mijë të punësuar paraqet institucionin më të madh numerikisht.

Suzana Radulloviq, sekretarja gjenerale e Unionit të Punëdhënësve, përmendi “Pesë vrasësit e biznesit”, botimin të cilin kjo shoqatë e botoi vitin e kaluar, i cili i dallon problemet e qeverisjes jo fort të mirë në Malin e Zi si pengesat kryesore për komunitetin e biznesit.

Këto janë, në mes tjerash, **korniza rregul-**

latore joadekuate, korrupsioni dhe përgjegjësia e mangët e organeve shtetërore dhe lokale, si dhe problemi i kompetencave dhe profesionalizmit të pamjaftueshëm.

Ajo vuri në dukje konsultimin e pamjaftueshëm të publikut gjatë miratimit të politikave publike.

“Ligjet miratohen, ndërsa ne nuk jemi aspak në dijeni”, tha ajo.

Timo Ligi, këshilltar i lartë në iniciativën e përbashkët të Komisionit Evropian dhe OECD – SIGMA, i përkujtoi pjesëmarrësit për rezultatet fillestare të cilat i arriti Mali i Zi në matjen e përmbushjes së Parimeve Evropiane të Administratës Publike, të cilat janë formuluar në vitin 2014 pikërisht me qëllim që të shërbejnë si një lloj kornize për vlerësimin e gatishmërisë së vendeve, të cilat dëshirojnë të kyçen në Unionin Evropian (UE).

“Në krahasim me vendet e tjera, Mali i Zi mori një notë të mirë”, konsideron Ligi.

Mirëpo, problemet, të cilat ai i vuri në dukje, kryesisht kanë të bëjnë me **procesin e miratimit të ligjeve dhe politikave të tjera publike**, i cili nuk është i bazuar në fakte, e as në vlerësimin e duhur të ndikimit.

Ai po ashtu vuri në dukje problemin e organeve në përbërje, posaçërisht në aspektin e përcaktimit të përgjegjësisë për mënyrën se si këto organe funksionojnë.

Millena Millosheviq, hulumtuese në Institutin alternativa, vuri në dukje se

disa ligje të tjerë sistemorë e tejkaluan punën relativisht të mundimshme në përpilimin e Strategjisë së Reformës së Administratës Publike.

Sipas fjalëve të saj, Ligji për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe ndryshimet e propozuara të Ligjit për Nëpunësit Shtetërorë dhe Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, vënë në pikëpyetje qëllimin themelor të reformës e që është një administratë efikase e orientuar kah shërbimi, të cilën e karakterizon rritja e besimit të qytetarëve në punën e saj.

“Prandaj, pyetja e duhur për organet kompetente, të cilën unë edhe më parë e kam bërë, por pa përgjigje bindëse, është në të vërtetë kjo – çka ne në të vërtetë dëshirojmë të arrijmë me Strategjinë e Reformës së Administratës Publike dhe çka do të bëjmë nëse zbatimi i saj do t’i zhveshë edhe më tepër këto mangësi sistemore për të cilat tash heshtim”, shtoi ajo.

Diskutimi i pjesëmarrësve në konferencë po ashtu vuri në dukje problemin e shpenzimeve të mëdha të cilat i paguajnë qytetarët për shkak të papërgjegjësisë së organeve të administratës.

Njërin nga këto probleme e tregoi edhe Raporti i Institucionit Shtetëror të Revizionit nga marsi i vitit 2016, sipas të cilit në periudhën midis viteve 2012-2015 janë shpenzuar mbi 70 milionë euro në bazë të vendimeve gjyqësore kundër shtetit të cilat paguhen në mënyrë të detyrueshme.

REFORMA NË NIVELIN LOKAL: FINANCAT PUBLIKE NË FOKUS

Në kuadër të projektit, vëmendje të veçantë i kushtuam nivelit lokal. Ne organizuam dy konferenca: në Kollashin, në korrik të vitit 2017 dhe në Ulqin, në mars të vitit 2018. Në të dy ngjarjet diskutimi pati të bëjë me sfidat kyçe të reformave të vetëqeverisjeve lokale në Malin e Zi, të cilat përfshijnë borxhin e akumuluar tatimor dhe punësimin e tepërt. Duke qenë se zbatimi i Ligjit për Procedurë Administrative ka filluar më 1 korrik 2017, këto ngjarje kanë qenë një mundësi për të shkëmbyer mendimet dhe informatat mbi parakushtet për zbatimin e këtij akti të rëndësishëm.

Në ngjarjen në Kollashin u theksua se niveli i lartë i punësimit në komuna paraqet ngarkesë për financat publike.

“Në Komunën e Kollashinit qytetarët sigurisht do të thonë se nuk janë të kënaqur, por ata ndajnë dyfish më pak të holla për financimin e vetëqeverisjes lokale sesa kanë ndarë para disa viteve, ndërsa marrin të njëjtin nivel të shërbimeve”, tha **Perunika Popoviq**, administratorja kryesore në Komunën e Kollashinit.


Ajo po ashtu tërhoqi vëmendjen te Ligji i ri për Procedurën Administrative, zbatimi i të cilit ka filluar më 1 korrik 2017, në të njëjtin muaj kur u organizua kjo ngjarje.

“Nëpunësit nuk duhet të veprojnë sipas urdhrave, por sipas ligjit”, theksoi ajo, duke cekur se Ligji i ri për Procedurën Administrative parashikon emërimin e nëpunësve të posaçëm të autorizuar dhe përgjegjës për procedurim administrativ.

Goran Rakoçeviq, sekretar për financa dhe administratë të përgjithshme në Komunën e Kollashinit, tha se kjo komunë

tash një vit është financiarisht e qëndrueshme përmes shumë veprimeve jo-popullore.

“Për dhjetë vjet do të shihet se nuk ka pasur rrugë tjetër, më e keqja ka kaluar dhe tash do të duhej të flasim për zhvillim dhe zgjerim. Unë besoj në zhvillimin të cilin e bëjnë njerëzit”, shtoi ai.





Senad Crnovrshanin, nga Drejtoria për Vetëqeverisje Lokale në Ministrinë e Administratës Publike, u përqendrua në rolin e organeve qendrore në orientimin strategjik të zhvillimit të vetëqeverisjeve lokale.

Ai prezantoi edhe vendimet e Projektligjit aktual në atë kohë për Vetëqeverisje Lokale, i cili u miratua në dhjetor të vitit 2017.

“Ligji i ri e ruan formën monotipe të vetëqeverisjes lokale (e cila nënkupton që të gjitha komunat, pavarësisht nga madhësia e tyre, të kenë të njëjtat kompetenca), por janë propozuar edhe një sërë zgjidhjesh për përmirësimin e funksionimit të vetëqeverisjes lokale”, tha Crnovrshanin.

Ai theksoi se disa dispozita i referohen rregullimit të kohëzgjatjes së manda-

tit të kuvendit, futjes së sanksioneve për kryerje të papërgjegjshme të punëve dhe forcimit të kontrollit të funksionit të kuvendit përmes detyrimit që të shqyrtojë raportet e Institucionit Shtetëror të Revizionit.

“Me qëllim të racionalizimit, është propozuar që kryetari i komunës të ketë më së shumti dy nënkryetarë”, shtoi ai.

Crnovrshanin theksoi se monitorimi i punës së nëpunësve lokalë përmes vlerësimit është një instrument i rëndësishëm i planifikimit të kuadrove.

“Për këtë arsye, vetëqeverisjet lokale mbajnë përgjegjësinë se çfarë kuadrit do të kenë”, shpjegoi Crnovrshanin, duke përkujtuar se është duke u definuar metodologjia për përcaktimin e numrit optimal të të punësuarve në vetëqeverisjet lokale.

Snezhana Mugosha, kryeshefe e Drejtorisë së Ministrisë së Financave, nën juridiksionin e të cilës është mbikëqyrja e buxhetit të vetëqeverisjeve lokale, iu referua sistemit të financave publike në nivelin lokal.

“Kur bëhet fjalë për shpenzimet, pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë pagat bruto, shpenzimet kapitale dhe shlyerja e obligimeve nga periudha e mëparshme”, theksoi ajo, duke theksuar se shpenzimet për të ardhurat e të punësuarve mesatarisht arrijnë nga 40 deri 45 milionë euro në nivel vjetor.

Aktualisht është duke u përgatitur Projektligji për Financimin e Vetëqeverisjeve Lokale, i cili parasheh formimin e një fondi që do t'i shërbente komunave për të siguruar mjetet që mungojnë për projektet e UE. Po ashtu, parasheh ndryshimin e kriterëve për shpërndarjen e mjeteve nga Fondi Egalizues.


Millan Mikan Medenica, drejtor ekzekutiv i OJQ Natura nga Kollashini, tha se shpesh sektori joqeveritar perceptohet si kërcënim, edhe pse procesi i reformës së administratës publike kërkon punë të përbashkët të sektorit joqeveritar, mediave dhe institucioneve zyrtare.

“Jemi dëshmitarë se administrata shpesh nuk është shërbim për qytetarët”, tha ai, duke përkujtuar se në periudhën e kaluar Komuna e Kollashinit ishte vend i punësimit të tepruar dhe shpenzimit të buxhetit në kurriz të qytetarëve.

Millena Millosheviq, hulumtuese në Institutin alternativa, solli ndër mend se gjatë vitit të parë të zbatimit të Strategjisë së Reformës së Administratës Publike, 60 % e aktiviteteve nuk janë kryer brenda afatit të caktuar.

“Strategjia aktuale është në të vërtetë më tepër Strategji e Reformës së Administratës Shtetërore, sepse masat e shumta,





të cilat duhet të zbatohen edhe në nivelin lokal, nuk e gjetën vendin në këtë dokument strategjik”, theksoi Millosheviq.

Ajo solli ndër mend edhe rekomandimet e mëparshme të Institutit alternativa për të bërë një analizë të suksesit të vetëqeverisjeve lokale në veçanti në mbledhjen e të ardhurave vetanake dhe për të lidhur Administratën Tatimore dhe vetëqeverisjet lokale në pjesën e llogaritjes së shpërblimeve të koncesionit. Në këtë mënyrë, komunat do të ishin në gjendje të kishin një pasqyrë të të ardhurave që mund të priten nga koncesionet.

Gjatë diskutimit u bë fjalë për zvogëlimin e numrit të të punësuarve dhe racionalizimin e shpenzimeve, posaçërisht në shembullin e Komunës së Kollashinit.

Mirëpo, u cek se është shumë vështirë të gjendet kriteri për përcaktimin e numrit

optimal të të punësuarve, ndërsa përfaqësuesit e Komunës së Kollashinit theksuan se puna për analizën e vendeve të punës dhe të punëve të nevojshme në njësitë më të vogla të vetëqeverisjes lokale është më e thjeshtë se në nivel qendror.

Po ashtu, u theksua se në Komunën e Kollashinit 23 persona ishin të punësuar në mënyrë të paligjshme, para se u fillua racionalizimi i organeve lokale.

Në ngjarje u cek edhe fakti se komunat kanë vështirësi të gjejnë mjete për investime kapitale për shkak të detyrimit për të paguar borxhin tatimor dhe shpenzimet e mëdha për paga.

Gjatë konferencës së fundit në Ulqin gjithashtu u fol për evidencat e dobëta të pronës dhe të ardhurave të komunës, por u bë fjalë edhe për rritjen në suaza ligjore.

Nga Instituti alternativa u vë në dukje se

Ligji i ri për Vetëqeverisje Lokale nga dhjetori i vitit 2017 vazhdon të mos respektojë specifikat e nevojave lokale në fushën e marrëdhënieve të shërbimit civil.

Millena Millosheviq paraqiti edhe rezultatet e IA në lidhje me krijimin e parakushteve në vetëqeverisjet lokale për aplikimin e Ligjit për Procedurën Administrative.

„Ne jemi përqendruar në **emërimin e nëpunësve të autorizuar** për udhëheqjen e procedurës administrative dhe për vendimmarrje, si dhe për këmbimin e të dhënave, çka do t'i mundësonte qytetarëve që të mos mbledhin vetë dokumentet e domosdoshme për kryerjen e shërbimit”, tha Millosheviq.

Hulumtimi për emërimin e nëpunësve të autorizuar është realizuar përmes anketës elektronike, e cila është dërguar në adresat e 101 sekretariateve lokale në Malin e Zi.

„Ne morëm 38% të përgjigjeve, çka na tregon se rezultati nuk është reprezentativ, por për nga cilësia është mjaft i qartë. Nga secila komunë kemi marrë përgjigje nga të paktën një sekretariat, përveç Gucisë dhe Herceg Novit. Në shumicën e sekretariateve, në 20 sosh, ende nuk janë emëruar nëpunësit për udhëheqjen e procedurës administrative, deri sa në 19 po”, tha ajo. Ajo shtoi se **niveli i vendimmarrjes nuk do të ulet ashtu që të jetë më afër qytetarëve, nëse vendimet edhe më tej do t'i nënshkruajnë krerët e organeve, gjegjë. sekretarët.**

Këmbimi i të dhënave sipas detyrës zyr-

tare është edhe një risi tjetër e Ligjit për Procedurën Administrative. Mirëpo, në ngjarje është theksuar gjithashtu se është problematike që nuk ekzistojnë aktet nënligjore, të cilat definojnë se në çfarë afati kohor organet duhet të këmbajnë të dhënat me qëllim të marrjes së një vendimi.

Instituti alternativa, përveç hulumtimit të opinionit publik për perceptimin e administratës publike, përpiloi edhe një hulumtim inovativ, i cili nënkuptonte që anketuesit e trajnuar të vizitojnë vetëqeverisjet lokale.

Ajo që është interesante është se **Ulqini, nga tetë komuna, ka marrë notën më të mirë gjatë hulumtimit përmes teknikës së vizitorit të fshehtë gjatë vitit 2017.** Anketuesit kanë vlerësuar se përmbushja e standardit të shërbimit është rreth 80%, edhe pse kjo përqindje më tepër i referohet afërsisë, dashamirësisë së nëpunësve dhe cilësisë së përgjigjeve në pyetjet e vizitorëve.

Kryeshefi në Drejtorinë për Përcjelljen e Dispozitave dhe Çështjet Normative në Ministrinë e Administratës Publike, **Senad Crnovrshanin**, tha se sistemi i vetëqeverisjes lokale në një moment nuk ka dhënë shërbime cilësore dhe nuk i siguroi qytetarëve status më të mirë dhe kjo ishte arsyeja për sjelljen e Ligjit të ri për Vetëqeverisje Lokale. Ai tha se me rastin e përpilimit të Ligjit janë kujdesur për qëndrueshmërinë e sistemit, duke shtuar se mbledhja e taksave dhe borxhi i madh tatimor janë ndër problemet më të mëdha.

Crnovrshanin tha se më herët kanë ekzistuar zgjidhjet ligjore, të cilat në praktikë çonin deri te zgjidhje të papërshtatshme, p.sh. që komunat të kenë më shumë nënkryetarë. Me Ligjin e ri për Vetëqeverisjen Lokale, siç tha ai, numri i nënkryetarëve është i kufizuar, si edhe numri i ndihmës-sekretarëve.

“Ligji i sjell qartë zgjidhjet dhe është më i mirë se i mëparshmi. Më parë kanë ekzistuar tituj të cilët nuk kanë ekzistuar në dispozita... Në periudhën e ardhshme na pret miratimi i akteve nënligjore. Ministria e Administratës Publike është duke ndërmarrë aktivitete konkrete për realizimin e Planit të Optimizimit të Numrit të të Punësuarve në Nivel Lokal”, tha Crnovrshanin.

Ai konstatoi se një numër i madh i komunave ka problem me numrin e tepërt të të punësuarve. Shtoi se është problematike gjetja e mjeteve për shpërblime të pensionimit dhe që, p.sh., Komuna e Bijello Poles planifikon të pushojë nga puna 100 nëpunës.

Nënkryetarja e Komunës së Tivarit, **Sanella Lliçina**, theksoi se e kanë kup-tuar rëndësinë e reformës së administratës publike, çka është bazë për vazhdimin e negociatave për anëtarësim në Unionin Evropian, duke shtuar se qëllimi i përgjithshëm i aktiviteteve të reformës është një administratë publike shërbimi, e orientuar kah qytetarët.

Lliçina vuri në dukje se Komuna e Tivarit ka krijuar parakushte për implemen-timin e Ligjit për Procedurën Administra-

tive dhe se është nevojshme që të kalojë të paktën një vit nga fillimi i aplikimit për të parë efektet e para.

“Që nga fillimi i aplikimit të Ligjit për Pro-cedurën Administrative janë caktuar nëpunësit për procedurën administrative dhe ata e përmbushin detyrën e tyre”, tha Lliçina. Shtoi se gjatë vitit 2017 nga Gjyqi Administrativ kanë mbërritur 20 aktgjy-kime, të dhëna sipas padive kundër ven-dimeve të komunave, prej të cilave janë miratuar vetëm tri sosh.

Lliçina tha se Komuna në faqen e inter-netit publikon Statutin, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës, buxhetin, raportet, vendimet dhe kontratat.

Ajo gjithashtu konstatoi se qytetarët nuk i shfrytëzojnë mekanizmat e pjesëmarrjes në vendimmarrje:

“Diskutimet publike realizohen në paj-tim me dispozitat dhe publikohen rapor-tet, por prania e qytetarëve është shumë e papërfillshme dhe nuk është në nivel të kënaqshëm”.

Nazif Veliq nga OJQ Horizonti i Ri njoftoi se është krijuar një bashkëpunim shumë i mirë në mes të sektorit joqeveritar dhe Kuvendit të Komunës së Ulqinit.

“Organizatat lokale joqeveritare shpesh e përdorin institucionin e Karriges së Lirë, në mënyrë që të përcjellin qëndrimet e qytetarëve dhe të ndikojnë në cilësinë e vendimeve të parlamentit lokal... Në të tre këshillat lokale përfaqësuesit e OJQ-ve kanë përfaqësuesit e tyre”, tha ai.

Veliqi theksoi se Horizonti i Ri përmes

monitorimit ka arritur në përfundim se Komuna e Ulqinit vetëm pjesërisht publikon informacione me rëndësi publike.

“Në faqen zyrtare ka qëndruar lista e pavarlefshme e këshilltarëve, udhëzuesit për qasje të lirë në informata nuk janë përditësuar, Rregullorja e Punës nuk është e publikuar në sajt. Komuna e Ulqinit, edhe përkundër kërkesës, nuk e ka miratuar Vendimin për Pjesëmarrjen e Qytetarëve në Kryerjen e Punëve Publike”.

Sekretarja e Sekretariatit për Administratë dhe Veprimtari Shoqërore në Komunën e Ulqinit, **Mirjeta Gjoni**, tha se cilësia e punës së administratës është në pikëpyetje.

Ajo konstatoi se pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje është shumë e vogël, edhe pse në sajtin e Komunës publikohen të gjitha informacionet. Mirëpo, gjatë diskutimit u vë në dukje se qytetarët nuk kanë qenë të informuar për mbajtjen e diskutimit publik për buxhetin e Komunës së Ulqinit për vitin 2018.

Gjatë konferencës në Ulqin u theksua praktika e mirë e Komunës së Tivarit në mbledhjen e tatimeve në patundshmëri. U theksua gjithashtu edhe domosdoshmëria e mbajtjes së regjistrave të pronës komunale dhe nevoja e lidhjes së vetëqeverisjeve lokale me Administratën Tatimore, në mënyrë që komunat të kenë një pasqyrë në mbledhjen e mjeteve të cilat u jepen atyre nga niveli qendror.

QË REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE TË MOS MBETET VETËM NË LETËR!

Gjatë projektit, monitorimi jonë i reformës së administratës publike bazohej në kriteret e mëposhtme:

- arritshmërinë e të dhënave;
- vlerën shtesë të cilën mund ta realizojnë organizatat e shoqërisë civile;
- rëndësinë e aktiviteteve të reformës për qytetarë.

Në bazë të këtyre kriterëve, janë zgjedhur katër fusha në të cilat jemi përqendruar më tepër:

- ofrimi i shërbimeve;
- përgjegjësia, organizimi dhe transparenca e administratës publike;
- zhvillimi dhe koordinimi i politikave publike dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje;
- menaxhimi i burimeve njerëzore.

Numri i çështjeve në fushën e reformës së administratës publike, me të cilat mund të merren organizatat e shoqërisë civile, është i pashtershëm. Ajo që gjithsesi meriton vëmendjen më të madhe të akterëve të jashtëm janë çështjet të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me qytetarët dhe monitorimi i të cilave kërkon ekspertizë të veçantë të cilën e posedon shoqëria civile.

VEPRIMI I INSPEKSIONIT ADMINISTRATIV SIPAS INICIATIVAVE TË QYTETARËVE

Inspeksioni Administrativ mbikëqyr zbatimin e dispozitave për procedurën administrative, administratën shtetërore dhe nëpunësit shtetërorë, si dhe për fushat e tjera në pajtim me ligjet e veçanta. Ai tash funksionon si Repart i posaçëm brenda Ministrisë së Administratës Publike. Mirëpo, raportimi për punën e tij nuk është mjaft transparent, edhe pse bëhet fjalë për një trup i cili do të duhej të jetë garantuesi kyç për procedim më të përgjegjshëm administrativ. Inspeksioni Administrativ është i obliguar që të ndërmarrë çdo iniciativë në punë, por radha dhe afati i përgjigjes në iniciativat e qytetarëve nuk është i përcaktuar në mënyrë eksplicite me Ligj.

Për këtë arsye kjo fushë meriton një angazhim më të madh të shoqërisë civile.

"HAPJA" E TË DHËNAVE

Të dhënat e hapura janë të dhëna elektronike, të cilat janë të arritshme pa pasur nevojën të blejmë një program të caktuar. Ato janë në dispozicion në tërësi dhe në formë transparente, që lejon ndryshimin e përmbajtjes. Pra, ato nuk janë të dhëna

të cilat administrata i fsheh në të ashtuquajturat dokumente dhe skanime. Të dhënat e hapura janë vetëm ato të cilat mund të përdoren prapë jashtë zonës së burimit dhe mund të shpërndahen dhe kombinohen me bazat e tjera të të dhënave, ndërsa askush nuk mund të diskriminohet ose të ndalohej t'i përdorë, ripërdorë dhe t'i shpërndajë ato. Për këtë arsye, të dhënat e hapura janë një aleat i natyrshëm i shoqërisë civile, e cila mund t'i përdorë ato, jo vetëm për nevoja të hulumtimit, por edhe për qëllime praktike përmes krijimit të aplikacioneve të reja.

Portali i të Dhënave të Hapura të Qeverisë së Malit të Zi fillon punën më 20 maj 2018. Ende nuk jemi në dijeni se cilat grupe të të dhënave do të jenë të arritshme në domenin datagov.me.

Shoqëria civile ka interes të drejtpërdrejtë që me qasje në të dhëna të hapura të shkurtohet koha dhe pritja e gjatë për përgjigjet në kërkesa për Qasje të Lirë në Informacion. Megjithatë, në çfarë mase do ta përdorin organet shtetërore portalin e të dhënave të hapura varet edhe nga presioni i jashtëm, të cilin mund ta arrijnë bashkë organizatat e shoqërisë civile!

PERSPEKTIVA GJINORE E POLITIKAVE PUBLIKE

Politikat publike të bazuara në fakte, të bëra me një qëllim të qartë për t'iu përgjigjur problemeve konkrete krahas vlerësimit të ndikimit të tyre (analiza

e ndikimit të dispozitave), janë një prej qëllimeve të reformës së administratës publike.

Politikat publike (ligjet, strategjitë) nuk kanë ndikim vetëm në financa, përmes shpërndarjes së buxhetit me qëllim të zbatimit të tyre, por edhe në marrëdhëniet më të gjëra në shoqëri.

Për këtë arsye, Ligji për Barazi Gjinore obligon vendimmarrësit që në të gjitha fazat e planifikimit, miratimit dhe zbatimit të vendimeve, si dhe të ndërmarrjes së aktiviteteve brenda juridiksionit të tyre, të notojë dhe të vlerësojë ndikimin e këtyre vendimeve dhe aktiviteteve në statusin e grave dhe burrave. Mirëpo, Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Pakicave, e cila mbikëqyr zbatimin e këtij Ligji, do të bëjë një analizë të zbatimit të këtij akti vetëm në fund të vitit 2018.

Prandaj, shoqëria civile duhet të kërkojë raporte të rregullta për aspektin gjinor të politikave publike. Nga angazhimi dhe presioni jonë varet edhe rregullsia e institucioneve për të zbatuar detyrimet e tyre ligjore.

PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE

Qeveria ka premtuar që gjatë vitit 2018 do të punojë në një akt nënligjor, i cili do të rregullojë realizimin e diskutimeve publike dhe bashkëpunimin me organizatat joqeveritare.

Mirëpo, në fund të vitit 2017 janë miratuar ndryshimet e Ligjit për Administratë

Shtetërore, sipas të cilave organet nuk janë të obliguara të realizojnë diskutime publike kur ligji ose strategjia rregullon çështjet nga fushat e mbrojtjes dhe sigurisë dhe buxhetit vjetor, në raste urgjente ose të paparashikueshme, si dhe kur ligji nuk e rregullon qenësisht ndryshe një çështje.

Paralelisht me miratimin e ndryshimeve ligjore kontroverse, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal dhe Shkolla Rajonale për Administratë Publike, organizatat rajonale në të cilat është e anëtarësuar Qeveria jonë, kanë miratuar Rekomandimet për Pjesëmarrjen e Qytetarëve në Procesin e Vendimmarrjes për Ballkanin Perëndimor.

Rekomandimet janë shumë më të avancuara sesa korniza ligjore aktuale, por, ndër të tjera, varet nga ne që t'i përcjellim dhe vlerësojmë deri në ç'masë do t'iu përmbahet administrata jonë.

ARRITSHMËRA ELEKTRONIKE DHE FIZIKE E ADMINISTRATËS SONË

Nuk ka të dhëna se sa organet e administratës janë fizikisht të arritshme për persona me invaliditet dhe madje edhe më pak se sa janë të arritshme faqet e tyre të internetit në mënyrë elektronike.

Sipas rezultateve të hulumtimit përmes teknikës së vizitorit të fshehtë, i cili është realizuar brenda këtij projekti, edhe në rastet kur hyrja në selitë e organeve shtetërore dhe lokale është fizikisht e arritshme për personat me invaliditet,

lëvizja e tyre nëpër ndërtesë nuk është e mundshme.

Në vitin 2017, Ministria e Administratës Publike miratoi Udhëzimet për Krijimin e Dokumenteve Elektronike në përputhje me standardet e e-arritshmërisë, mirëpo zbatimi i tyre nuk po përcillet në mënyrë sistematike.

KUNDËRSHTIM NDAJ OFRIMIT TË SHËRBIMEVE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM

A e dini se Ligji i ri për Procedurën Administrative, i cili është në fuqi nga 1 korriku 2017, fut një institucion me të cilin edhe më tepër mbrohen të drejtat tuaja?

Fokusi është, ndër të tjera, edhe në shërbimet të cilat i ofrojnë organet me qëllim të përmbushjes së interesit publik, siç janë furnizimi me ujë, grumbullimi i mbeturinave ose mirëmbajtja e ndriçimit publik.

Nëse mendoni se janë shkelur të drejtat tuaja me rastin e ofrimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm, mund të parashtroni kundërshtim te organi i cili mbikëqyr ofrimin e shërbimit publik konkret.

Sa do të përdoret ky institucion, varet nga gatishmëria jonë për të kërkuar shërbime më të mira!

PËR INSTITUTIN ALTERNATIVA

Ky institut vepron si Think Tank, përkatësisht si një qendër kërkimore dhe në punën e vet merret me qeverisjen e mirë, transparencën dhe llogaridhënien. Fushat në të cilat IA punon dhe vepron janë të strukturuar brenda këtyre programeve: administrata publike, financat e përgjegjshme publike, programi parlamentar, siguria dhe mbrojtja. Në kuadër të këtyre programeve merret edhe me monitorimin e procesit të negociatave për anëtarësimin në BE, duke marrë pjesë aktive në grupet punuese për kapitujt 23 dhe 32. Aktivitet i veçantë i kësaj organizate është Shkolla e Politikave Publike që organizohet prej vitit 2012. IA është licencuar nga Ministria e Shkencës, në vitin 2013 si një institut për kërkime shkencore.

Projekti "Shoqëria Civile për Qeverisje të Mirë: Shërbim dhe Meritë!" financohet nga Bashkimi Evropian, në kuadër të programit mbështetës për zhvillimin e shoqërisë civile dhe Fondit Ballkanik për Demokraci (FBD), një projekt i Fondit Gjerman Marshall (FGM). Projekti implementohet nga Instituti Alternativa, Bonum, Natura, Horizonti I Ri dhe Qendra për Gazetari Hulumtuese. Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i praktikës së qeverisjes së mirë në Mal të Zi.

MOJA UPRAVA

WWW.MOJAUPRAVA.ME

www.institut-alternativa.org

www.mojgrad.me

www.mojauprava.me

www.mojnovac.me